VENDIM
Nr. 72, datë 13.4.2022

MBI MIRATIMIN E TARIFËS SË TRANSMETIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE PËR PERIUDHËN 2022–2024

Në mbështetje të neneve 16, 19, germa "c", pika "i", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; nenit 15 dhe nenit 22, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 244, datë 30.3.2016, "Kushtet për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike", të ndryshuar; VKM-së nr. 584, datë 8.10.2021, "Për shpalljen e gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike"; "Metodologjisë së llogaritjes së tarifave të transmetimit të energjisë elektrike" miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 180, datë 8.11.2017, si dhe vendimit të Bordit të ERE-s nr. 244, datë 26.11.2018, "Për miratimin e sistemit të njësuar dhe të standardizuar të llogarive për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike për aktivitetet e transmetimit, shpërndarjes dhe furnizuesit të shërbimit universal të energjisë elektrike"; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 13.4.2022, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 486/1 prot., datë 11.4.2022, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe e Çmimeve, "Mbi miratimin e tarifës së transmetimit të energjisë elektrike për periudhën 2022–2024.

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 234, datë 19.11.2021, vendosi për "Fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë OST sh.a., për tarifën e transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2022 dhe për periudhën 2022–2024".

- Procesi i shqyrtimit të aplikimit ka kaluar nëpërmjet rishikimit të vazhdueshëm të kërkesës për të ardhura nga OST sh.a., fillimisht me kërkesën drejtuar në ERE, me anë të shkresës nr. 5215 prot., datë 31.8.2021 dhe, më tej, përditësimin tij me anë të shkresave nr. 5215/1 prot., datë 5.10.2021, nr. 5215/3 prot., datë 4.11.2021 dhe nr. 6901/3 prot datë 23.12.2021.

- Më datë 3.12.2021 u zhvillua seanca teknike ndërmjet përfaqësuesve të ERE-s dhe të shoqërisë OST sh.a. lidhur me informacionin, argumentet dhe dokumentacionin e paraqitur nga shoqëria në aplikim.

- Gjatë procesit të shqyrtimit të aplikimit, në kuadër të nevojës për sqarime të mëtejshme, ERE nëpërmjet korrespondencave të vazhdueshme, ka kërkuar nga OST sh.a. dhënien e informacionit, argumenteve dhe dokumentacionit justifikues lidhur me të gjitha çështjet e evidentuara, për efekt të ruajtjes së parimit të transparencës dhe për marrjen e një vendimi sa më të drejtë e kosto reflektues.

- Në përputhje me pikën 7, të nenit 22, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, ERE zhvilloi më datë 29.12.2021, seancën dëgjimore publike me përfaqësues nga shoqëria OST sh.a., si dhe me palët e interesit, lidhur me aplikimin për përcaktimin e tarifës së transmetimit për vitin 2022 dhe periudhën rregullatorë 2022–2024.

- Në zbatim të afateve të përcaktuara në "Rregulloren për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", është kryer publikimi në faqen elektronike të ERE-s: www.ere.gov.al, të aplikimit, si dhe çdo korrespondence të depozituar nga shoqëria OST sh.a.

- Shoqëria OST sh.a. ka depozituar parashikimin e saj lidhur me kërkesën për energji për periudhën rregullatorë 2022–2024, mbështetur në mesataren historike të energjisë të transmetuar nga OST sh.a., për konsum, si dhe gradientin në rritje të kërkesës për energji prej 1%.

- Shoqëria OST sh.a., me shkresën nr. 851/1 prot., datë 14.2.2022, deklaroi se pasqyrat financiare të plota të vitit 2021 janë ende në proces hartimi dhe përcolli pasqyrën pozicionit financiar, pasqyrën

e të ardhurave dhe shpenzimeve, raportin mbi aktivitetin e OST sh.a. për vitin 2021, si dhe parashikimet e saj për shërbimet ndihmëse për periudhën 2022–2024.

- Kosto e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin e transmetimit për periudhën 2022–2024 është konsideruar, sipas vlerave të propozuara nga shoqëria OST sh.a., për çdo vit të periudhës rregullatore.

- Të ardhurat e krijuar nga shërbimet ndihmëse të ofruara për KOSTT-në janë zbritur në përllogaritjen e shpenzimeve ndihmëse të realizuara gjatë vitit 2021 dhe vlera e shpenzimeve ndihmëse për periudhën e ardhshme rregullatore është përllogaritur sipas realizimit faktik të këtij shpenzimi për vitin 2021.

- Baza e Rregulluar e Aseteve dhe Amortizimi i akumuluar është vlerësuar në të ardhurat e kërkuara sipas kostos historike të deklaruar nga OST sh.a.

- Vlera e investimeve të parashikuara për t'u realizuar në periudhën rregullatore 2022–2024, është konsideruar sipas parashikimit të "Planit 10-vjeçar të zhvillimit të rrjetit të transmetimit (2015–2025)", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 212, datë 28.12.2017.

- OST sh.a. duhet të paraqesë planin e investimeve për periudhën rregullatore 2022–2024 dhe përditësimin e planit të zhvillimit të rrjetit të transmetimit për periudhën 10-vjeçare 2015–2025, në zbatim të "Rregullores për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 135, datë 6.9.2017, dhe përcaktimet e pikës 3 të VKM-së nr. 584/2021.

- Kosto mesatare e ponderuar e kapitalit të shoqërisë OST sh.a. për periudhën 2022–2024 është përllogaritur në nivelin 2.28%.

- Të ardhurat e krijuara nga tregu shqiptar i balancimit për vitin 2020 për OST sh.a. kanë rezultuar 220 milionë lekë, ndërkohë që për vitin 2021 pas hyrjes në fuqi të Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të miratuara me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 106, datë 2.7.2020, janë deklaruar në vlerën 1.7 miliardë lekë. Këto të ardhura do të jenë të korrigjueshme përgjatë periudhës rregullatore.

- Të ardhurat e krijuara për periudhën 2019–2021 nga alokimi i kapaciteteve, si dhe ato të parashikuara për periudhën 2022–2024 sipas vlerësimeve të ERE-s, janë konsideruar si të ardhura të zbritshme.

. Të ardhurat e kërkuara, që priten të realizohen nga OST sh.a., janë llogaritur për periudhën rregullatore 2022–2024 dhe tarifa e re të transmetimit të energjisë elektrike, e cila do t'i shtrijë efektet nga data 1 maj 2022, është përllogaritur duke konsideruar dhe diferencën e korrigjueshme të të ardhurave të kërkuara për periudhën janar–prill 2022, për efekt të rikuperimit të të ardhurave të pafaturuara në 4-mujorin e parë. Kjo diferencë nuk ndikon në tarifën mesatare të transmetimit për periudhën 2022–2024 dhe do të korrigjohet në zbritje të të ardhurave të kërkuara në vitin e dytë të periudhës rregullatore.

. Tarifat e transmetimit të energjisë elektrike për çdo vit të periudhës rregullatore 1 maj 2022–31 dhjetor 2024, rezultojnë: a) 0.85 lekë/kwh për periudhën 1 maj 2022–31 dhjetor 2022; b) 0.89 lekë/kwh për vitin 2023; c) 0.83 lekë/kwh për vitin 2024.

. Nga sa më sipër, tarifa e transmetimit për periudhën rregullatore 1 maj 2022–31 dhjetor 2024, rezulton 0.85 lekë/kwh.

- Tarifat e transmetimit të energjisë elektrike për çdo vit të periudhës rregullatore 2022–2024 rezultojnë: a) 0.85 lekë/kwh për vitin 2022; b) 0.89 lekë/kwh për vitin 2023; c) 0.83 lekë/kwh për vitin 2024.

- Të ardhurat e kërkuara që priten të realizohen nga OST sh.a. janë llogaritur për periudhën rregullatore 2022–2024 dhe tarifa e re të transmetimit të energjisë elektrike, e cila do t'i shtrijë efektet nga data 1 maj 2022, është përllogaritur duke konsideruar dhe diferencën e korrigjueshme të të ardhurave të kërkuara për periudhën janar–prill 2022, për efekt të rikuperimit të të ardhurave të pafaturuara në 4-mujorin e parë. Kjo diferencë nuk ndikon në tarifën mesatare të transmetimit për periudhën 2022–2024 dhe do të korrigjohet në zbritje të të ardhurave të kërkuara në vitin e dytë të periudhës rregullatore.

- Nga sa më sipër, tarifa e transmetimit për periudhën rregullatore 1 maj 2022–31 dhjetor 2024, rezulton 0.85 lekë/kwh.

- ERE do të rishikojë të ardhurat e kërkuara përgjatë periudhës rregullatore, në përputhje me përcaktimet "Metodologjisë së llogaritjes së tarifave të transmetimit të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 180, datë 8.11.2017.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s:

VENDOSI:

1. Miratimin e tarifës së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike për periudhën rregullatore 1 maj 2022–31 dhjetor 2024, prej 0.85 lekë/kwh.

2. Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë palët e interesuara për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti